



KOSOVO SPECIALIST CHAMBERS
DHOMAT E SPECIALIZUARA TË KOSOVËS
SPECIJALIZOVANA VEÇA KOSOVA

Numri i lëndës : KSC-BC-2020-06/IA036
KSC-BC-2020-06/IA037
KSC-BC-2020-06/IA038
KSC-BC-2020-06/IA040

Vendosi: Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit
Gjykatëse Mishelë Pikar
Gjykatës Kai Ambos
Gjykatëse Nina Jorgensen

Administratore: Fidelma Donlon

Data: 10 korrik 2025

Gjuha: Anglishte

Klasifikimi: Publik

**Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët për Shtimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për
Dorëzimin e Apelit Përmbledhës kundër Vendimeve mbi Pranimin e Provave**

Zyrës së Prokurorit të Specializuar

Kimberli P. Uest

Mbrojtjes së Hashim Thaçit:

Luka Mishetiç

Mbrojtjes së Viktimave:

Sajmon Loz

Mbrojtjes së Kadri Veselit:

Rodni Dikson

Mbrojtjes së Rexhep Selimit:

Xhefri Roberts

Mbrojtjes së Jakup Krasniqit:

Venkatesvari Alagendra

PANELI I DHOMËS SË GJYKATËS SË APELIT i Dhomave të Specializuara të Kosovës (përkatësisht, "Paneli i Gjykatës së Apelit" ose "Paneli" dhe "Dhomat e Specializuara"),¹ bazuar në nenin 33(1)(c) të Ligjit për Dhomat e Specializuara të Kosovës dhe Zyrën e Prokurorit të Specializuar ("Ligji") dhe rregullën 169 të Rregullores së Procedurës dhe të Provave ("Rregullorja"), merr në shqyrtim mocionin e përbashkët të dorëzuar më 8 korrik 2025 ("Kërkesa") nga ekipet e Mbrojtjes së z. Hashim Thaçi, z. Kadri Veseli, z. Rexhep Selimi dhe z. Jakup Krasniqi (së bashku, "Mbrojtja" dhe "të akuzuarit").² Zyra e Prokurorit të Specializuar ("ZPS") u përgjigj më 9 korrik 2025.³

1. Mbrojtja kërkon që t'i miratohet dorëzimi i një apeli përmbledhës ("Apeli Përmbledhës"), ku të trajtojë pesë pikat e autorizuara për apel nga Trupi Gjykses ("pikat e autorizuara"),⁴ në lidhje me: Vendimin mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të Dëshmitarit W04875 ("F03202"); Vendimin mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të W04826-ës ("F03201"); Vendimin mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të W04874-ës ("F03203"); Vendimin mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve në lidhje me Viktimat e Vrasjes së Paligjshme dhe Kërkesën në lidhje me To ("F03211"); dhe Vendimin mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Raporteve Ndërkombëtare

¹ IA036/F00001, IA037/F00001, IA038/F00001, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 4 korrik 2025; IA040/F00001, Vendim për Caktimin e Panelit të Gjykatës së Apelit, 9 korrik 2025.

² IA036/F00002, IA037/F00002, IA038/F00002, IA040/F00002, Kërkesë e Përbashkët e Mbrojtjes drejtuar Panelit të Gjykatës së Apelit, 8 korrik 2025 ("Kërkesa").

³ IA036/F00003, IA037/F00003, IA038/F00003, IA040/F00003, Përgjigje e Prokurorisë ndaj Kërkesës së Përbashkët të Mbrojtjes drejtuar Panelit të Gjykatës së Apelit, 9 korrik 2025 ("Përgjigjja").

⁴ Shih F03297, Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të Dëshmitarit W04875, 1 korrik 2025 ("Vendimi F03297 mbi Lejen për Apel"); F03298, Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët Përmbledhëse të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Pranimin e Dëshmise si Ekspert të Dëshmitarëve W04826 dhe W04874, (F03201 dhe F03203), 1 korrik 2025 ("Vendimi F03298 mbi Lejen për Apel"); F03299, Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve në lidhje me Viktimat e Vrasjes së Paligjshme dhe Kërkesën në lidhje me To, 1 korrik 2025 ("Vendimi F03299 mbi Lejen për Apel"); F03312, Vendim mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Raporteve Ndërkombëtare, 7 korrik 2025, (Vendimi F03312 mbi Lejen për Apel").

("F03213") (së bashku, "Vendimet e Kundërshtuara").⁵ Nëse kërkesa për dorëzimin e Apelit Përmbledhës miratohet prej Trupit Gjykses, Mbrojtja gjithashtu kërkon shtimin e 6 000 fjalëve.⁶

2. ZPS-ja përgjigjet se nuk kundërshton kërkesën e Mbrojtjes për dorëzimin e Apelit Përmbledhës, por se Paneli duhet të refuzojë shtimin e numrit të fjalëve.⁷ ZPS-ja më tej parashtron se Paneli duhet të caktojë si afat për dorëzimin e Apelit Përmbledhës të premtën, 11 korrik 2025.⁸ Së fundi, nëse Paneli autorizon shtimin e numrit të fjalëve dhe/ose zgjatjen e afatit të Mbrojtjes, ZPS-ja kërkon që t'i autorizohet shtim proporcional i fjalëve dhe zgjatje proporcionale e afatit për përgjigjen e saj.⁹

3. Sa i përket kërkesës për dorëzimin e Apelit Përmbledhës, të akuzuarit parashtrojnë se pikat e autorizuara kanë të bëjnë me interpretimin dhe zbatimin e rregullës 149 të Rregullores.¹⁰ Duke pasur parasysh ngjashmërinë e pikave të autorizuara dhe në interes të efikasitetit dhe shpejtësisë së procesit, Mbrojtja

⁵ Kërkesa, para. 1. Vendimet e Kundërshtuara janë: F03202, Vendim mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të Dëshmitarit W04875, 27 maj 2025 ("F03202"); F03201/COR, Version i Korrigjuar i Vendimit mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të W04826-ës, 16 qershor 2025 (versioni i pakorrigjuar u dorëzua më 27 maj 2025) ("F03201"); F03203, Vendim mbi Pranimin e Dëshmisë si Ekspert të W04874-ës, 27 maj 2025 ("F3203"); F03211/RED, Version i Redaktuar Publik i Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Dokumenteve në lidhje me Viktimat e Vrasjes së Paligjshme dhe Kërkesën në lidhje me To, 29 maj 2025 (versioni konfidencial u dorëzua më 29 maj 2025) ("F03211"); F03213, Vendim mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Raporteve Ndërkombëtare, 29 maj 2025 ("F03213").

⁶ Kërkesa, para. 3.

⁷ Përgjigja, para. 1.

⁸ Përgjigja, para. 2.

⁹ Përgjigja, para. 3. ZPS-ja konkretisht kërkon, nëse Paneli autorizon Mbrojtjen të dorëzojë Apelin Përmbledhës deri më 18 korrik 2025, që Paneli t'i autorizojë ZPS-së zgjatjen proporcionale të afatit prej shtatë ditësh për dorëzimin e përgjigjes ndaj tij. Shih gjithashtu Përgjigjen, para. 2. Paneli vëren pretendimin e ZPS-së se afati për dorëzimin e apelit lidhur me Vendimin F03312 mbi Lejen për Apel është 18 korriku 2025. Sidoqoftë, duke rikujtuar se Vendimi F03312 mbi Lejen për Apel u lëshua më 7 korrik 2025 dhe sipas rregullës 170(2) të Rregullores, apeluesi mund ta paraqesë apelin brenda 10 ditësh nga dhënia e lejes, Paneli konfirmon se afati për dorëzimin e apelit kundër Vendimit F03312 është të enjten, 17 korrik 2025. Contra Përgjigja e ZPS-së, para. 2, poshtëshënimi 8.

¹⁰ Kërkesa, para. 2.

argumenton se ekzistojnë arsye të vlefshme që të akuzuarit të dorëzojnë një Apel Përmbledhës.¹¹

4. Në mungesë të ndonjë dispozite konkrete në Rregullore, Paneli gjykon se, në këtë rast, është përgjegjësi e Mbrojtjes për të vendosur nëse do t'i dorëzojnë apelet e ndërmjetme të tyre së bashku në një dokument përmbledhës dhe jo individualisht, në dokumente të veçanta. Gjithsesi, Paneli miraton kërkesën e Mbrojtjes për dorëzimin e një Apeli Përmbledhës.¹² Paneli mirëpret këtë nismë për dorëzimin e një Apeli Përmbledhës kundër Vendimeve të Kundërshtuara, i cili do të jetë më i shkurtër dhe mund të paraqesë edhe argumente më të qarta e më logjike duke trajtuar pikat që përkojnë me njëra-tjetrën në një parashtrim të vetëm.¹³

5. Sa i përket dorëzimit brenda afatit të kërkesës së Mbrojtjes për shtimin e numrit të lejuar të fjalëve, Paneli i Apelit kujton se kur jepet leja për apel sipas rregullës 77(3) të Rregullores, apeluesi mund ta dorëzojë apelin brenda 10 ditësh nga dhënia e autorizimit. Pala përgjigjëse mund ta dorëzojë përgjigjen brenda 10 ditësh nga apeli.¹⁴ Paneli thekson se afati për dorëzimin e apeleve normalisht do të ishte të premten, 11 korrik 2025 për Vendimet F03202, F03201, F03203, F03211¹⁵ dhe, të enjten, 17 korrik 2025 për Vendimin F03212.¹⁶ Paneli është bindur se, në përgjithësi, Kërkesa u dorëzua paraprakisht në kohë të mjaftueshme sipas kuptimit të nenit 36(1) të Udhëzuesit të

¹¹ Kërkesa, para. 2.

¹² Kërkesa, para. 2.

¹³ Shih p.sh. IA024/F00007, Vendim mbi Kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për Zgjatjen e Afatit dhe Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Dorëzimin e Përgjigjes Përmbledhëse, 16 shtator 2022, ("Vendimi mbi Kërkesën e ZPS-së për Zgjatjen e Afatit dhe Shtimin e Numrit të Fjalëve për Dorëzimin e Përgjigjes Përmbledhëse"), para. 5; IA012/F00010, Vendim mbi Kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Dorëzimin e Përgjigjes Përmbledhëse, 1 dhjetor 2021 ("Vendimi mbi Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së"), para. 2.

¹⁴ Rregulla 170(2) e Rregullores.

¹⁵ Shih Vendimin F03297 mbi Lejen për Apel, Vendimin F03298 mbi Lejen për Apel, Vendimin F03299 mbi Lejen për Apel.

¹⁶ Shih Vendimin F03212 mbi Lejen për Apel.

Punës për Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës ("Udhëzuesi i Punës").¹⁷

6. Lidhur me arsyetimin në kërkesën e Mbrojtjes për shtimin e numrit të lejuar të fjalëve, të akuzuarit parashtrojnë se dyfishimi i numrit të fjalëve në një apel përmbledhës në të cilin trajtohen pikat e autorizuara do të ishte shumë më i volitshëm për të gjitha palët se sa katër apele të veçanta prej 6 000 fjalësh secili, gjithsej 24 000 fjalë.¹⁸ Nga ky parashtrim, Paneli kupton se Mbrojtja synon të paraqesë një Apel Përmbledhës me jo më shumë se 12 000 fjalë.

7. Paneli kujton se neni 46(2) i Udhëzuesit të Punës përcakton se apelet e ndërmjetme dhe përgjigjet ndaj tyre nuk duhet të jenë më shumë se 6 000 fjalë. Gjithashtu, neni 36(1) i Udhëzuesit të Punës përcakton se pjesëmarrësit në proces mund të kërkojnë paraprakisht në kohë të mjaftueshme, shtimin e numrit të lejuar të fjalëve duke treguar se ekzistojnë arsye të vlefshme që përbëjnë rrethana posaçme.¹⁹

8. Sa i përket faktit nëse Mbrojtja ka treguar se ekzistojnë arsye të vlefshme në lidhje me kërkesën për shtimin e numrit të lejuar të fjalëve, në kundërshtim me parashtrimet e ZPS-së,²⁰ Paneli është bindur se në interes të efikasitetit e shpejtësisë, dhe për arsye lidhur me qartësinë dhe logjikën e parashtrimeve të përshkruara më lart,²¹ ekzistojnë arsye të vlefshme për miratimin e shtimit të numrit të fjalëve të kërkuara në Apelin Përmbledhës.²²

¹⁷ KSC-BD-15, Udhëzues Pune i Zyrës Administrative, Dosjet dhe Parashtrimet e Protokolluara para Dhomave të Specializuara të Kosovës, 17 maj 2019.

¹⁸ Kërkesa, para. 3.

¹⁹ Shih p.sh. Vendimin mbi Kërkesën e ZPS-së për Zgjatjen e Afatit dhe Shtimin e Numrit të Fjalëve për Dorëzimin e Përgjigjes Përmbledhëse, para. 3; Vendimi mbi Ndryshimin e Numrit të Lejuar të Fjalëve për Përgjigjen Përmbledhëse të ZPS-së, para. 2.

²⁰ Përgjigja, para. 1.

²¹ Shih më lart, para. 4.

²² Shih Kërkesën, para. 2.

9. Paneli vëren se Mbrojtja nuk kërkon zgjatjen e afatit për dorëzimin e Apelit Përmbledhës. Sidoqoftë, sikurse theksoi ZPS-ja,²³ dy afate të ndryshme për dorëzimin e apeleve, përkatësisht 11 korrik 2025 dhe 17 korrik 2025,²⁴ kërkojnë përcaktimin e afatit përkatës nga Paneli i Apelit. Paneli pranon sugjerimin e ZPS-së që data e afatit të jetë 11 korriku 2025.²⁵ Megjithatë, Paneli konstaton se rrethanat aktuale përlligjin që afati për dorëzimin e Apelit Përmbledhës të fillojë nga data e dorëzimit të vendimit të fundit mbi lejen për apel të lëshuar në lidhje me Vendimet e Kundërshtuara,²⁶ përkatësisht, të Vendimit mbi Kërkesën e Përbashkët të Mbrojtjes për Leje për Apelim të Vendimit mbi Mocionin e Prokurorisë për Pranimin e Raporteve Ndërkombëtare të lëshuar më 7 korrik 2025.²⁷ Rrjedhimisht, në bazë të rregullës 9(5)(a), Paneli vendos *proprio motu* se Apeli Përmbledhës duhet të dorëzohet jo më vonë se më 17 korrik 2025.

10. Së fundi, Paneli mban parasysh kërkesën e ZPS-së që t'i miratohet shtim proporcional të fjalëve dhe zgjatje proporcionale të afatit me ato të miratuara për Mbrojtjen për përgjigjen e saj ndaj Apelit Përmbledhës.²⁸ Në rrethanat aktuale, Paneli konstaton se është në interes të administrimit efektiv të çështjes që të urdhërojë ZPS-së të dorëzojë një përgjigje përmbledhëse ndaj Apelit Përmbledhës që nuk i kalon 12 000 fjalë. Paneli gjykon se data 17 korrik 2025, në vetvete nuk përbën zgjatje afati për dorëzimin e Apelit Përmbledhës, por thjesht interpretim i rregullave mbi bazën e

²³ Përgjigja, para. 2.

²⁴ Shih më lart, para. 5.

²⁵ Përgjigja, para. 2.

²⁶ Paneli vë në dukje se rregullat nuk ofrojnë udhëzime të qarta në lidhje me afatin e zbatueshëm për dorëzimin e një apeli përmbledhës në rrethana si kjo e tanishme, ku vendimet mbi lejet për apel janë lëshuar në data të ndryshme. Paneli vendos që të ndjekë, mbi bazën e analogjisë, qasjen e përcaktuar në rregullën 179(6) të Rregullores, sipas të cilës: "Përveçse kur paneli i Gjykatës së Apelit urdhëron ndryshe, nëse Prokurori i Specializuar apelon një aktgjykim lidhur me disa persona të shpallur të pafajshëm ose fajtorë, ai dorëzon dosje të përbashkët të apelit. Afati për dorëzimin e dosjes së përbashkët llogaritet prej datës së dorëzimit të dosjes së fundit të apelit, apo të dosjes së përgjigjes të personave të shpallur të pafajshëm ose fajtorë, sipas rrethanave". Shih rregullën 179(6) të Rregullores.

²⁷ Shih Vendimin F03212 mbi Lejen për Apel.

²⁸ Përgjigja, para. 3.

analogjisë.²⁹ Gjithsesi, Paneli është i vetëdijshëm se afati i caktuar në këtë Vendim është në favor të Mbrojtjes. Në rrethanat aktuale dhe duke pasur parasysh parashtrimin e ZPS-së se, nëse Paneli vendos ta caktojë afatin më 17 korrik 2025 afati i përgjigjes së ZPS-së do binte gjatë periudhës së pushimit të Gjykatës,³⁰ Paneli e zgjat me shtatë ditë afatin për ZPS-së dhe urdhëron që çdo përgjigje ndaj Apelit Përmbledhës të dorëzohet brenda 17 ditësh nga data e njoftimit të Apelit Përmbledhës.³¹

11. Për arsyet e lartpërmendura, Paneli i Dhomës së Gjykatës së Apelit:

MIRATON Kërkesën;

AUTORIZON Mbrojtjen të dorëzojë Apelin Përmbledhës, me jo më shumë se 12 000 fjalë, deri më 17 korrik 2025; dhe

URDHËRON ZPS-në të dorëzojë një përgjigje përmbledhëse ndaj Apelit Përmbledhës me jo më shumë se 12 000 fjalë, brenda 17 ditësh nga dita e njoftimit të Apelit Përmbledhës.

²⁹ Shih më lart, poshtëshënimin 26.

³⁰ Përgjigja, para. 2.

³¹ Paneli kujton se ndonëse pushimi i Gjykatës nuk përbën në vetvete arsye të vlefshme për zgjatjen e afatit, disponueshmëria e kufizuar e punonjësve gjatë pushimit mund të jetë faktor për miratimin e zgjatjes së afatit. Shih p.sh. KSC-CA-2023-02, F00004, Vendim mbi Kërkesën e Mbrojtjes për Ndryshimin e Afatit për Dorëzimin e Njoftimit për Apel, 9 janar 2023, para. 6; Shih KSC-BC-2023-10, IA001/F00004, Vendim mbi Kërkesën e Zyrës së Prokurorit të Specializuar për Zgjatje të Afatit, 28 dhjetor 2023 (konfidencial, u riklasifikua si publik më 28 shkurt 2024), para. 3.

/nënshkrimi/

Gjykatëse Mishelë Pikar

Kryegjykatëse

E enjte, 10 korrik 2025

Në Hagë, Holandë.